



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PML.nr.397/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi, kryetar i kolegjit, Mejreme Memaj dhe Afrim Shala anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtëse në çështjen penale kundër të pandehurit A. S., etj., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179, paragrafi 1. pika 1.6., lidhur me nenin 33, paragrafi 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.243/22 të datës 09.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN1.DKR.nr.699/2023 të datës 04.07.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 09.08.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses të pandehurit A. S., të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, P.nr.243/22 të datës 09.06.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN1.DKR.nr.699/2023 të datës 04.07.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin P.nr.243/22 të datës 09.06.2023, të pandehurit M. S., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179, paragrafi 1. pika 1.4, dhe 1.6. të KPRK-së, të pandehurit A. S., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179, paragrafi 1. pika 1.6., lidhur me nenin 33, paragrafi 1. të KPRK-së, të pandehurit B. R., për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179, paragrafi 1. pika 1.8. lidhur me nenin 32, paragrafi 1. të KPRK-së, iu ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy)

muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi, paraburgimi do t'iu llogaritet nga data 10.06.2023 e deri me datën 10.08.2023. Të pandehurve paraburgimi iu është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1., e 1.2., pika 1.2.1. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktvendimin PN1.DKR.nr.699/2023 të datës 04.07.2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses të pandehurit dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit A. S., avokate Kosovare Kelmendi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2., pika 2.1., sepse të dy gjykatat kanë shkelur dispozitën ligjore nga neni 5 paragrafi 1., 2. dhe 3. të KPP-së dhe neni 171 paragrafi 2. të KPP-së, si dhe shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që të aprovohet kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktvendimet e kundërshtuar të anulohen ashtu që ndaj të pandehurit të ndërpritet menjëherë masa e paraburgimit dhe i njëjti të lëshohet në liri, ose t'i caktohet ndonjë masë tjetër alternative.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.166/2023 të datës 09.08.2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, mbrojtësja thekson se aktvendimet e atakuara nuk përmbajnë asnjë arsyetim të bazuar por vetëm paraqesin një prototip arsyetimi, se i pandehuri gjendet në paraburgim afër 7 (shtatë) vite e me këtë rast është duke u rrezikuar çdo standard i një gjykimi të drejtë dhe në afat të arsyeshëm ligjor, se gjykatat nuk kanë paraqitur se cilat janë dyshimet e bazuara se i akuzuari ka rrezik të arratisjes apo të përsëritjes së veprës penale, i njëjti i premton gjykatës se nuk do të largohet nga shtëpia e tij, ku jeton me nënën, bashkëshorten dhe fëmijët e tij dhe njëkohësisht nuk do të kontaktojë me askënd tjetër përveç me anëtarët e familjes së ngusht.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike aktakuza është ngritur në bazë të provave të cilat argumentojnë dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penal për të cilën ngarkohet, kurse a

do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 184 par.1 nën par.1.1 të KPP-së për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.1. të KPP-së, ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, duke pasur parasysh faktin se i njëjti ka ndërmarr veprime konkrete direkte dhe se vepra penale për të cilën dyshohet është e natyrës së rëndë, për të cilën, nëse i njëjti shpallet fajtor, parashihet dënim mjaft i lartë, andaj me gjetjen e tij në liri i njëjti do të mund të arratiset me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale, e në këtë mënyrë do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Gjithashtu, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 184, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pika 1.2.3. të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, pasojat kanë përfunduar me vrasjen e viktimës për shkak të përfitimeve materiale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, raportet mes familjarëve si dhe duke marrë parasysh karakteristikat personale, këmbëngulësinë e të pandehurit në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për të arritur deri te pasoja konkrete, andaj masa e paraburgimit është e nevojshme për zhvillimin e rregullt të procedurës penale dhe pengimin e të pandehurit nga kryerja e veprave tjera penale .

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.397/2023, më datë 09.08.2023

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetar i kolegjit,
Rasim Rasimi